

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nesrin Lushta, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Emine Mustafa, anëtare, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini- Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit R.B., për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 261 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, duke vendosur sipas kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.4353/15 datë 30.12.2016 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAI.nr.703/2017 të datës 18.07.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 11.04.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit R.B., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.4353/15 datë 30.12.2016 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAI.nr.703/2017 të datës 18.07.2017.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.4353/15 datë 30.12.2016, të dënuarin R.B., e ka shpallur fajtor, për veprën penale mashtrimi nga neni 261 par.2 lidhur me par.1 i KPK-së, dhe e ka dënuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, të cilin dënim do ta vuajë, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë. Në dënimin e shqiptuar i është llogaritur koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 25.01.2010 deri në datën 25.02.2010, në emër të paushallit gjyqësor është obliguar që të paguaj shumën prej 300€, në afat prej 15 ditësh nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë. I dëmtuari nuk ka paraqitur kërkesë pasuroro- juridike.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAI.nr.703/2017 të datës 18.07.2017, ka aprovuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit R.B., av. B.T., dhe ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.4353/2015 i datës 30.12.2016, vetëm përkitazi me vendimin për dënim, ashtu që të dënuarin, për veprën penale mashtrimi nga neni 261par.2 lidhur par.1 i KPK-së e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 25.01.2010 deri më 25.02.2010.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati B.T., nga Prishtina, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar, që të aprovohet kërkesa si e bazuar, të anulohen aktgjykimet e kundërshtuara dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Mendimi i Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit i Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.II.nr.5/2018 e datës 25.01.2018, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit, të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit, vetëm janë përshkruar bazat e kërkesës dhe njëkohësisht propozimi që të aprovohet kërkesa dhe çështja të kthehet për rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Kërkesa nuk përmban arsyetim përkitazi me pretendimet, mirëpo propozohet që ankesa e paraqitur në Gjykatën e Apelit të Kosovës, të konsiderohet pjesë integrale e kërkesës së paraqitur e po ashtu potencohet se arsyetimi i plotë i kësaj kërkesë do të bashkëngjitet ditën e parë të punës pas festës së 28 nëntorit. Mirëpo, arsyetimi plotësues i potencuar në kërkesë nuk është dorëzuar në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e mbajtur shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes dhe në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pasi vlerësoi pretendimet në kërkesë konstatoi se:

Kërkesa është e pabazuar.

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit, përveç faktit se paraqet bazat e kërkesës përkatësisht shkeljet e dispozitave të procedurës penale dhe shkeljet e ligjit penal, nuk paraqet pretendime të arsyetuara, e për më tepër, thekson se kërkesa do të plotësohet, mirëpo plotësimi i tillë nuk është bërë deri me rastin e vendosjes së kësaj kërkesë.

Pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit që ankesa e paraqitur në Gjykatën e Apelit të Kosovës, të konsiderohet pjesë integrale e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, është në kundërshtim me natyrën e mjetit të jashtëzakonshëm juridik, meqë secili mjet juridik e në rastin konkret, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, duhet të arsyetohet specifikisht dhe të paraqiten pretendime konkrete.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstatojë se konform dispozitës se nenit 436 par.1 të KPPK-së:

“Me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon.”

Andaj, duke marrë parasysh këtë përkufizim ligjor dhe faktin se në kërkesë nuk është paraqitur asnjë pretendim i arsyetuar, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishe e pabazuar dhe konform nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.11/2018, më datë 11.04.2018

Bashkëpunëtori profesional,
Mirlinda Mejzini- Simnica

Kryetarja e kolegjit,
Nesrin Lushta